



## **RREGULLORE PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOORDINUES TË QENDRËS SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT**

### **Neni 1**

#### **Objekti**

1.1.Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

### **Neni 2**

#### **Baza ligjore**

2.1. Kjo rregullore hartohet në mbështetje të VKM nr.601, datë 04.09.201, “Për Krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët” dhe legjislacionit në fuqi.

### **Neni 3**

#### **Qëllimi**

3.1.Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat lidhur me kushtet dhe mënyrën për:

- a) Organizimin dhe Funksionimin e mbledhjes së Këshillit;
- b) Shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve në mbledhjen e Këshillit;
- c) Mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit;

### **Neni 4**

#### **Përkufizime**

4.1.Për qëllime të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) QSPA, është Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ;

- b) “Këshilli” është Këshilli Koordinues i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.
- c) “Projekt” janë projektvendimet, projekt programet, projekt propozimet, projekt rregulloret si dhe çdo material apo informacion i cili kërkon miratim nga Këshilli.

## **Neni 5**

### **Thirrja e mbledhjes**

- 5.1.Këshilli mbledhet jo më shumë se 4 herë në vit.
- 5.2. Mbledhja e Këshillit thirret me propozim të Drejtorit të QSPA-së. Thirrja duhet të përmbajë qëllimin, çështjet që do të diskutohen në mbledhje dhe materialet përkatëse, të cilat duhet të dërgohen paraprakisht me e\_mail.
- 5.3.Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve të Këshillit ose nga Drejtori i QSPA-së.
- 5.4.Thirrjet për mbledhjen duhet të bëhen nëpërmjet postës elektronike në adresën zyrtare të e-mailit përkatës për secilin anëtar të Këshillit, 10 (dhjetë) ditë pune para datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit. Data e njoftimit të anëtarit të Këshillit do të konsiderohet data e dërgimit të njoftimit.
- 5.5.Njoftimi për mbledhjen duhet të përmbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, si dhe materialin që do të shqyrtohet.
- 5.6.Mbledhja e Këshillit, si rregull, zhvillohet në selinë e QSPA-së, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.
- 5.7.Mbledhja e Këshillit, në raste të veçanta mund të thirret edhe në ditët e pushimit ose ditët e festave zyrtare.

## **Neni 6**

### **Përgatitja e materialeve dhe paraqitja e tyre në mbledhjen e Këshillit**

- 6.1.Materialet për shqyrtim në mbledhjet e Këshillit paraqiten nga Drejtori i QSPA-së. Drejtori i QSPA-së si rregull i propozon Kryetarit të Këshillit çështjet që duhet të përfshihen në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të QSPA-së dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj. Këto çështje duhet të propozohen në mënyrë paraprake.
- 6.2.Strukturat e QSPA-së mund të paraqesin materiale në Këshill vetëm nëpërmjet Drejtorit të QSPA-së ose në rast mungesë nga njëri prej Përgjegjësve të Sektorëve të QSPA-së të autorizuar prej tij.
- 6.3.Drejtori i QSPA-së paraqet sa herë që i kërkohet nga Këshilli raporte dhe informacione mbi zbatimin e vendimeve të Këshillit dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me detyrat e Këshillit.
- 6.4.Materialet që paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit ndahen në dy grupe si më poshtë:

- a) Materiale me propozime konkrete që janë të detyrueshme të shqyrtohen në mbledhjet e Këshillit, të cilat mund të miratohen pa ndryshime, me ndryshime ose mund të mos miratohen. Materialet e kësaj natyre për efekt të kësaj rregulloreje do të quhen “Projekt”;
  - b) Materiale me karakter të përgjithshëm dhe informativ të cilat për efekt të kësaj rregulloreje do të quhen “Informacione”.
- 6.5.Çdo “Projekt” duhet t’i bashkëlidhet relacioni që shpjegon qëllimin, rëndësinë, bazueshmërinë ligjore si dhe përfshirjen e mendimit të strukturave të tjera të interesuara për çështjen që shqyrtohet. Relacioni nënshkruhet nga drejtuesi i strukturës që e ka përgatitur atë.

## **Neni 7**

### **Zhvillimi i mbledhjes**

- 7.1.Mbledhja e Këshillit drejtohet nga Kryetari dhe në mungesë të tij, nga anëtari përfaqësues i Akademisë së Shkencave.
- 7.2.Mbledhja e Këshillit është e vlefshme nëse marrin pjesë shumica e thjeshtë anëtarëve të Këshillit me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon një kuorum tjetër. Në rastet kur nuk plotësohet ky numër, Kryetari e shtyn mbledhjen për një ditë tjetër, duke njoftuar për këtë qëllim dhe anëtarët që nuk ishin të pranishëm në mbledhje.
- 7.3. Kur dikush nga anëtarët e Këshillit nuk mundet të jetë i pranishëm fizikisht, pjesëmarrja mund të bëhet nëpërmjet video-konferencës në kohë reale, e cila regjistrohet dhe konsiderohet e vlefshme.
- 7.4.Në fund të mbledhjes, Kryetari deklaron mbylljen e saj. Nëse çështjet e rendit të ditës nuk shqyrtohen brenda ditës së mbledhjes, Kryetari mund të vendosë shqyrtimin e tyre në mbledhjen tjetër të Këshillit, ose të shtyjë mbledhjen për një ditë tjetër.
- 7.5.Në mbledhjen e Këshillit merr pjesë edhe sekretari i Këshillit, i cili mban procesverbalin.
- 7.6.Sekretari i Këshillit caktohet me vendim të Këshillit Koordinues.
- 7.7.Në mbledhjen e Këshillit është gjithmonë i pranishëm edhe Drejtori i QSPA-së ose në rast mungese njëri prej Përgjegjësve të QSPA-së të autorizuar prej tij. Në mbledhje, me miratimin e Kryetarit të Këshillit, mund të ftohen edhe përfaqësues të QSPA-së, specialistë të sektorëve të QSPA-së apo ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me materialin e paraqitur në mbledhje.

## **Neni 8**

### **Procedura e marrjes së vendimeve dhe e votimit**

- 8.1.Çdo anëtar ka të drejtën e një vote.
- 8.2.Vendimi është i vlefshëm kur votojnë pro shumica e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon një shumicë tjetër.
- 8.3.Kryetari i Këshillit voton i fundit.
- 8.4.Në rast kur anëtarët e Këshillit të pranishëm në mbledhje janë numër çift dhe votat e tyre ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit është përcaktuese.

- 8.5.Në votim nuk lejohet abstenimi.
- 8.6.Vota kundër argumentohet dhe pasqyrohet në procesverbal.
- 8.7.Në rastet kur nuk arrihet kuorumi i nevojshëm, votimi shtyhet për mbledhjen tjetër.
- 8.8.Procesi i votimit në të gjitha mbledhjet e Këshillit është i hapur.
- 8.9.Këshilli, si rregull miraton vendime mbi bazën e “Projektit” të paraqitur, por në raste të veçanta ai mund të marrë vendime edhe mbi bazën e informacioneve të paraqitura për shqyrtim apo propozimeve të bëra gjatë diskutimit në mbledhje.
- 8.10. Votimi bëhet i hapur. Kryetari numëron votat dhe mbi këtë bazë shpall rezultatin e votimit.
- 8.11. Për çdo “Projekt” të paraqitur, Këshilli merr vendim më vete. Në rastet kur në mbledhjen e Këshillit nuk ka vërejtje dhe nuk bëhen propozime për ndryshime, “Projekt” votohet dhe miratohet në formën e paraqitur.
- 8.12. Në rastet kur për “Projektin” e paraqitur në mbledhje bëhen vërejtje, “Projekt” votohet në parim dhe nëse votohet pro miratimit të tij, atëherë kalohet në votimin e çdo neni apo pike të “Projektit” së bashku me propozimet e bëra në mbledhje dhe në fund vendoset për “Projektin” me ndryshimet përkatëse. Në të kundërt “Projekt” nuk miratohet.
- 8.13. Në rastet kur “Projekt” nuk miratohet Këshilli nuk merr vendim dhe “Projekt” kthehet për plotësim. Strukturat propozuese të QSPA-së informohen me shkrim nga sekretari i Këshillit për plotësimet përkatëse.

## **Neni 9**

### **Zbardhja dhe marrja fuqi e vendimeve**

- 9.1.Zbardhja e vendimeve të Këshillit bëhet nga sekretari i Këshillit, brenda pesë ditëve pune pas ditës së përfundimit të mbledhjes.
- 9.2.Vendimet e nënshkuara depozitohen në zyrën e Protokoll-Arkivit të QSPA-së. Sekretari i Këshillit dorëzon në protokoll procesverbalin e mbledhjeve të Këshillit.
- 9.3.Drejtori i QSPA-së merr masa për zbatimin e vendimeve dhe u dërgon kopje të vendimeve të miratuara strukturave përkatëse, të cilat ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e tyre.
- 9.4.Nëse duhet, vendimet e miratuara publikohen në faqen zyrtare të QSPA-së.

## **Neni 10**

### **Mbajtja e Procesverbalit të mbledhjeve**

- 10.1.Dokumentimi i mbledhjeve të Këshillit mbahet nga sekretari i Këshillit me anë të procesverbaleve. Në procesverbal duhet që të tregohet pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit si dhe e të ftuarve të tjerë në mbledhje, diskutimet, propozimet, vërejtjet që bëhen në mbledhje si dhe rezultatet e votimit.

10.2.Në procesverbal Sekretari i Këshillit mban shënime për anëtarët e Këshillit që morën pjesë në mbledhje, pjesëmarrësit në mbledhje përfshirë, punonjësit e QSPA-së dhe ekspertë të jashtëm, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, formën dhe rezultatin e votimit, datën dhe vendin e mbledhjes.

10.3.Procesverbali i mbledhjeve të Këshillit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm dhe nga sekretari i Këshillit. Procesverbali miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen pasardhëse.

10.4.Në rastet kur mungon sekretari, Këshilli me propozim të Drejtorit të QSPA-së cakton një punonjës të administratës së QSPA-së për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

## **Neni 11**

### **Konflikti i interesit**

11.1.Çdo anëtar i Këshillit, përmes deklaramit me shkrim, duhet të kërkojë heqjen dorë nga pjesëmarrja në mbledhjen e Këshillit kur ndërmjet tij dhe personave ose subjekteve juridike për të cilat diskutohet, shqyrtohet, vlerësohet dhe kryhet çfarëdolloj procedure për çështje konkrete, ka konflikt interesi.

11.2.Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në procedurat e shqyrtimit, diskutimit dhe votimit, nëse ka interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjen, interes i cili cënon paanësinë e tyre në vendimet që do të merren, si dhe me qëndrimet zyrtare të QSPA-së.

## **Neni 12**

### **Shpërblimi i anëtareve të Këshillit Koordinativ**

12.1.Kryetari dhe Anëtarët e Këshillit përfitojnë pagesë për çdo pjesëmarrje të tyre në mbledhjet e Këshillit Koordinues në përputhje me VKM nr.656 datë 31.10.2018 *“Për Përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtareve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershme të Njësive të qeverisjes Qendrore ”* si më poshtë:

- Kryetari 5000 (pesë mijë) lekë;
- Anëtarët 5000 (pesë mijë) lekë.

## **Neni 13**

### **Dispozita të fundit**

13.1.Vlerësimet, debatet që bëhen gjatë shqyrtimit të materialeve të paraqitura dhe marrjes së vendimeve në Këshillin Koordinues janë konfidenciale.

13.2.Vendimet e Këshillit Koordinues janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha strukturat dhe punonjësit e QSPA-së.

13.3. Këshilli Koordinues organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

#### **Neni 14**

#### **Hyrja në fuqi**

14.1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**PANDELI MAJKO**